

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e praktikantes Besjana Çollaku procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 para.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2141-6/2016 të datës 06.12.2016, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e prokurorit të shtetit Elfete Purova, të akuzuarit dhe përkthyesit të gjykatës Prof. Fejzullah Shatri, me datë 13.11.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. M. nga i ati I. dhe e ëma A. e lindur A., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 08.03.2016 rreth orës 19:00, në Prizren pikërisht në shtëpinë e tyre familjare e cila gjendet në rrugën ... si pasojë e mosmarrëveshjeve në mes të prindërve të tij të cilët ishin duke u fjalosur në mes vete, me qëllim të mbrojtjes së nënës së tij në konflikt ndërhyjnë djali i tyre - i akuzuari i cili e godet me grushte të dëmtuarin – babanë e tij I. M. në fytyrë dhe atë në anën e majtë i cili nga këto goditje pëson ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të kokës të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Këso dore kryen veprën penale lëndimi i lehtë trupor neni 188 par.1 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 188 par.1 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHTË

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari I. M. nga Prizreni rruga ... nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë në shumen prej 20 €, kurse në

emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr.2141-6/2016 të datës 06.12.2016 kundër të akuzuarit A. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

I akuzuari A. M. në seancën e datës 13.11.2017, ka deklaruar se ditën kritike për shkak të problemeve familjare ka ardhur deri tek shkaktimi i lëndimit këtu të dëmtuarit I. M., për të cilin e ka pranuar fajësinë për veprën penale objekt i akuzës. Duke theksuar se qëllimi i tij nuk ka qenë që të vije deri tek rrahja por të qetësoj situatën.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 08.03.2016 në orët e mbrëmjes rreth orës 19:00, në Prizren në shtëpinë e tyre familjare, si pasojë mos marrëveshjeve në mes të prindërve të akuzuarit gjatë fjalosjes në mes vete, e me qëllim të qetësimit të situatës në konflikt ndërhyjnë edhe djali i tyre i akuzuari A. M. i cili e godet me grushte të dëmtuarin – babanë e tij I. M. në fytyrë dhe atë në anën e majtë, i cili nga këto goditje pëson ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të kokës të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasojë të përkohshme për shëndetin.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale siç janë ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. V. H. dhe Dr. F. D. të datës 08.10.2017 dhe shkresat tjera të lëndës të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në këtë mënyrë edhe është vërtetuar plotësisht gjendja faktike prandaj edhe në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kushte duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë,

rrethanat familjare – është mbajtës i vetëm i familjes, gjer më tani nuk ka qenë i gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoj dënimin me kushte sepse konsideron se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të KPPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2693/2016 të datës 13.11.2017

Procesmbajtësja
Besjana Çollaku

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.